



Bazuar në nenin 21 paragrafi 21.1 dhe 21.3 të Ligjit 03/L-087 për Ndërmarrjet Publike i plotësuar dhe ndryshuar me ligjet përkatëse, ne dispozitat e Statutit të NPL "Stacioni i Autobusëve" Sh.A. Prishtinë, pas përfundimit të procedurave të përzgjedhjes sipas konkursit nr.02/361 datë 12.03.2025, Komisioni i Auditimit mer këtë:

V E N D I M

- I. Mirlinda Ahmeti zgjedhet/emërohet Zyrtar i Auditimit të Brendshëm i NPL "Stacioni i Autobusëve" Sh.A. Prishtinë.
- II. E emëruara sipas pikës I-pare të këtij vendimi themelon mardhënie pune me kohë të caktuar, për tre vite (3) në NPL "Stacioni i Autobusëve" Sh.A. Prishtinë duke filluar nga data: 28.04.2025 deri me datë 28.04.2028.
- III. Me të emëruarën Mirlinda Ahmeti, Zyrtare e Auditimit të Brendshëm i NPL "Stacioni i Autobusëve" Sh.A. Prishtinë, lidhet kontrate mbi themelimin e mardhënies së punës me kohë të caktuar në harmoni me nenin 10 paragrafi 2.2 i Ligjit nr. 03/L – 212 të Punës dhe në harmoni me Ligjin për Ndërmarrjet Publike, Ligjin Për Shoqëritë Tregtare dhe Statutin e NPL "Stacioni i Autobusëve" Sh.A. Prishtinë.
- IV. Obligohet Sekretarja e ndërmarrjes të përgadis dhe përpiloj kontratën e punës sipas këtij vendimi.
- V. E emëruara sipas këtij vendimi obligohet që brenda afatit ligjor, të bëjë deklarinimin e pasurisë në harmoni me ligjin për deklarinimin e pasurisë.
- VI. Ky vendim hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit nga Kryesuesi i Komisionit të Auditimit.

A r s y e t I m

Komisioni i Auditimit i NPL “ Stacioni I Autobusëve” Sh.A.Prishtinë, duke u bazuar ne dispozitat e Ligjit për Ndërmarrje Publike me datë 12.03.2025 ka shpallur konkurs publik për Zyrtar i Auditimit të Brendshëm I NPL “Stacioni I Autobusëve” Sh.A.Prishtinë.

Komisioni i Auditimit i ndërmarrjes pas mbylljes së afatit për aplikim, ka realizuar shqyrtimin e të gjitha aplikacioneve dhe intervisimin e kandidatëve për poziten e Zyrtar i Auditimit të Brendshëm i NPL “Stacioni I Autobusëve” Sh.A.Prishtinë.

Komisioni i Auditimit, pas shqyrtimit të aplikacioneve dhe intervistimin e kandidatëve për poziten Zyrtar i Auditimit të Brendshëm i NPL “Stacioni i Autobusëve” Sh.A. Prishtinë, konstatoi se rezultatet me te mira ka treguar kandidati Mirlinda Ahmeti, i cili ka numrin me të madh te pikëve të grumbulluara.

Ne baze te rezultatit te vlerësuar, Komisioni i Auditimit unanimisht ka marr vendim qe për Zyrtar i Auditimit të Brendshëm të NPL “Stacioni i Autobusëve” Sh.A. Prishtinë, të zgjedh/emëroj Mirlinda Ahmeti, prandaj u vendos si ne dispozitiv te këtij vendimi.

Këshilla juridike: Kundër këtij vendimi, pala e pakënaqur mund të ushtrojë ankesë në gjykatën kompetente, konform dispozitave ligjore në fuqi.

T’i dërgohet

1.x1. Të përzgjedhurit;

1x1. Sekretarit

1.x1. Sherbimit te financave;

1.x1. Arkivit

Kryesuesi i Komisionit të Auditimit

